



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura e V-të**

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 34/15

Prishtinë, më 18.11.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjona, Latif Gashi, Labinot Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta.

Munguan: Jelena Bontic, Ilir Deda, Enver Hoti, Bali Muharremaj dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Ismet Krasniqi – Sekretari i Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu- Drejtor i Administratës, Istret Azemi- Drejtori i Buxhetit.

Gjithashtu të pranishëm ishin – Sanije Berisha – monitoruese nga OSCE, Fjolla Uka – monitoruese nga KDI, Sylejman Blaku – Gazetar nga Kosova Sot, Blerta Bejtullahu Senior Political Advisal nga Zyra e BE-së në Kosovë, Aleksandra Felinger, Rejhane Zylfijaj, Emma Kellner dhe Carolina Leersch nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashurije Canolli, Medina Agushi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, datë 04.11.2015;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmuajorin e vitit 2015;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Amendamenteve të Komisioni funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-51 për Treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-57 për Themelimin e fondit kosovar për garanci kreditore dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-58 për Dizajnin Industrial dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
8. **Të ndryshme.**

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** - konstatoj se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, datë 4.11.2015**

**Kryetari** - konstatoi e procesverbali miratohet pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2015**

**Ismet Krasniqi** - Raporti i Kuvendit për nëntmujorin e vitit 2015 në total përfshin shpenzimet e realizuara prej 83.21%, ndërsa sipas kategorive kryesore për paga dhe meditje 98.91%, mallra dhe shërbime 51%, shpenzimet komunale 84%, suvencione dhe transfere 57%, investimet kapitale 25.2%. Sipas pasqyrës së shpenzimeve del që investime kapitale ka një ngecje mirëpo në periudhën e katërt të raportimit kjo shumë do të jetë më e lartë, pasi që do të kryhen disa aktivitete që nuk kanë qenë të përfundume.

**Kryetari** -një pyetje që po e parashtrojnë gazetarët vazhdimisht është se deputete e opozites a janë duke bërë shpenzime këto muajt e fundit, përfshirë udhëtimet zyrtare?

**Ismet Krasniqi** – shpenzimet që bëhen nga buxheti i Kuvendit, kërkohet vendim i Kryesisë, ndërkaq lejimi i udhëtimeve jashtë vendit me financim të donatorit lejohen nga Kryetari i Kuvendit. Për udhëtimin e fundit i deputetes Shqipe Pantina, pas kthimit të saj, ka pas një reagim i cili ka qenë i adresuar në linjë jo me korrektësi, por ajo ka pas kërkesë për lejim të udhëtimit dhe në cilësinë e deputetes ka marrë pjesë në takim dhe as kthimit ajo ka bërë një kërkesë se nuk don me marrë mëditjen. Në këtë muaj ka pas kërkesa për udhëtime jashtë vendit, mirëpo sipas informacionit që kam marrë për shkak të nevojës së prezencës së deputetëve nuk iu janë lejuar udhëtimet as pozitës e as opozitës.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

#### **Rekomandim**

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2015.

### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Amendamenteve të Komisioni funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

**Kryetari** – Projektligji është vlerësuar se do të ketë kosto buxhetore shtesë, që është parashikuar për vitin 2017. Kostoja ka të bëjë me themelimin e instituteve hulumtuese, njësive shkencore e artistike dhe qendrave studimore. Meqë kemi të bëjmë me një Projektligj të Qeverisë, atëherë në procedurat e rregullta mund të ndahen mjete buxhetore.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

#### **Rekomandim**

1. Projektligji nr.05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, përmban kosto buxhetore të përballeshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, për Projektligjin nr.05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

**5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-51 për Treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

**Kryetari** – në bazë të vlerësimeve, Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

**Rekomandim**

1. Projektligji Nr. 05/L-51 për Treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin Nr. 05/L-51 për Treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

**6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-57 për Themelimin e fondit kosovar për garanci kreditore dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

**Kryetari** – kemi të bëjmë me një Pprojektligj, në hartimin e së cilit ka ndihmuar USAID dhe përmes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është proceduar në Kuvend edhe pse unë kam kërkuar që kjo të bëhet përmes Ministrisë së Financave. Sikur që kam kërkuar që Projektligji për Kambialin dhe Kamatvonesën që procedohen përmes Ministrisë së Financave.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

**Rekomandim**

1. Projektligji Nr. 05/L-57 për Themelimin e fondit kosovar për garanci kreditore, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin Nr. 05/L-57 për Themelimin e fondit kosovar për garanci kreditore, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

**7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-58 për Dizajnin Industrial dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.**

**Kryetari** – në bazë të vlerësimeve, Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

**Rekomandim**

1. Projektligji Nr.05/L-58 për Dizajnin Industrial, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Projektligjin Nr. 05/L-58 për Dizajnin Industrial, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

## **8. Të ndryshme**

**8.1. Kryetari** – nftotojë anëtarët se të martën do të mbahet një takim në mes Komisionit dhe një Misioni të Asistencës Teknike të FMN-së për bashkimin e Doganave dhe ATK-së. Qëllimi është që të shkëbejnë idetë në këtë proces. Po ashtu të martën prej orës 11:00 do të jetë një mbledhje e Komisionit, ku ndër pikat tjera do të radhitet për shqyrtim pjesa tekstuale e Projektbuxhetit 2016.

**8.2. Kryetari** – nftotoi anëtarët se Komisionet tjera të përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin për Sigurimet dhe amendamentet që kemi propozuar ne si komision funksional dhe Raporti final me amendamente për Projektligjin për Sigurimet është i gatshëm për procedim për miratim në lexim të dytë në Kuvend. Antëret e Komisionit mbështetën procedimin e Raporti final me amendamente për Projektligjin për Sigurimet është i gatshëm për procedim për miratim në lexim të dytë në Kuvend.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:43**

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Naser Osmani**